



REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E KLINES / MUNICIPALITY OF KLINA / OPŠTINA KLINA  
Nr.No.Br. 325 - 2607/13  
Data-Date-Datum 03.06.2013  
Klinë-Klina

**PROCESVERBAL**

**TKOMISIONIT PËR KONTROLLIN - PRANIMIN TEKNIK TË PUNIMEVE TË  
KRYERA NË OBJEKTIN**

**NDËRTIMI I FABRIKËS PËR SIGURIM TË UJIT TË PIJSHËM NË KLINË**

- CO: Investitorit – Komuna e Klinës
- CO: Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, K .Klinë
- CO: Kryesit të punimeve, Grupi i operatorëve: PC&E shpk, Klinë, PPV Tradind  
BV Leak Holand, dhe Turbia BV, Tilburg- Holand, që e përfaqëson z. Nol  
Berisha- Klinë.
- CO: Organit mbikëqyrës
- CO: Komisionit për pranim teknik

**Klinë – Maj 2013**

Me Vendimin e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, nr. 06, nr. 351-1973/2013, të datës: 27.03.2013, është formuar Komisioni për pranimin – kontrollin e punimeve të kryera të Projektit –Ndërtimin e Fabrikës për sigurimin e ujit të pijshëm – në Klinë, në këtë përbërje:

1. Mr. Shkëlzen Qorraj, fak. i Ndërtimtarisë, kryetar
2. Mr. Bekim Lushaku, fak. i Makinerisë, anëtar
3. Halil Berisha , përfaqësues i Hidro-Drinit zy. në Klinë
4. Esat Raci, anëtar
5. Ali Gashi, anëtar

Komisioni në përbërje të plotë ka dalë në terren-objekt, më datën,01.06.2013, në ora 11:00, ku pos pranisë së anëtarëve të Komisionit, prezent ishte edhe:

- Z. Fran Paloka, përfaqësues i ekzekutuesit të punimeve, **Grupi i operatorëve: PC&E shpk, Klinë, PPV Tradind BV Leak Holand dhe Turbia BV, Tilburg- Holand, që e përfaqëson z. Nol Berisha- Klinë**
- **Organi Mbikëqyrës**
  - **1. Rasim Millaku**
  - **2. Besart Gashi**
  - **3. Ndue Sherri**
  - **dhe**
  - **Z. Zeqir Morina – menaxher i Projektit.**

Detyra e Komisionit për kontrollin teknik ka qenë shqyrtimi i dokumentacionit tekniko- investiv në bazë të cilit është punuar, ndërtuar, Ndërtimi i fabrikës për sigurimin e ujit të pijshëm dhe shikimi i punëve të kryera në vend.

#### **I. Të dhënat e përgjithshme :**

- Investitori: Komuna e Klinës.
- Kryesi i punimeve, **Grupi i operatorëve: PC&E shpk, Klinë, PPV Tradind BV Leak Holand, dhe Turbia BV, Tilburg- Holand, që e përfaqëson z. Nol Berisha- Klinë.** Kontrata e punimeve me nr. Identifikimi:634-11-024-511, me numër protokolli 01nr.325-2242/2011 e lidhur në mes komunës se Klinës,dhe **Grupi i operatoreve: PC&E shpk, Klinë, PPV Tradind BV Leak Holand, dhe Turbia BV, Tilburg- Holand, që e përfaqëson z. Nol Berisha- Klinë,** datë: 11.07.2011, në vlerë 1.695.000,00 €.
- Kontrata e testimit të Fabrikës së ujit, nr. i identifikimit, 634-13-008-236, me nr, protokolli, 01 nr. 325-1097/13, e datës 20.02.2013.
- Leja e ndërtimit nr.06-351-4092/11 , e datës. 03.11.2011.
- Mendimi lidhur me ndotjen e ambientit i lëshuar nga Drejtoria e Bujqësi, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, i datës: 30.12.2011.
- Vendimi , për menaxhimin e Kontratës, 01 nr. 355-2242/11 , i datës 07.09.2011.
- Vendimi për formimin e Komisionit Mbikëqyrës, nr. 01.325-2242/11, i datës. 30.09.2011.
- Projekti kryesor (i kompletuar).
- Organi mbikëqyrës.

**Vlera totale e projektit ne bazë te kontratës të lart cekura, është 1.695.000,00 €.**

## II. Kontrolli i dokumentacionit teknik :

- Projekti i gjendjes së ekzekutuar të Fabrikës së ujit të pijshëm - Klinë.
- Ditari i punës i nënshkruar nga organi mbikëqyrës;
- Testi i I-rë (parë) i analizave të ujit të pijshëm shifra e mostrës 3-04-13, i bërë më datën, 05.04.2013;
- Testi i II-të (dytë) i analizave të ujit të pijshëm shifra e mostrës, 24-05-13, i bërë më datën, 23.05.2013;
- Atestet e gypit kryesor dhe atyre zbarkues sipas ISO 9001:2008, i lëshuar nga INET i datës 21.02.2011;
- Dokumentacioni përcjellës, garancionet e aparaturës së Fabrikës;
- Atestet e betonit e lëshuar nga Benita Comani-sh.p.k. e datës. 27.03.2013;
- Raporti kryesor i kontrollimit të Fabrikës së ujit – Klinë, i datës 15. 03. 2013, i bërë nga Instituti i Shkencës dhe Teknologjisë, Prishtinë;
- Marrëveshja mes Komunës së Klinës dhe operatorit ekonomik të lartcekur të datës 08.07.2011;
- Raporti përfundimtar i datës. 14.04.2013;
- CD- fotot .

## III. Kontrolli i punëve të kryera në vend:

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të lartpërmendur, anëtarët e komisionit nga lëmi i punëve profesionale në praninë e përfaqësuesit të ekzekutuesit të punimeve dhe personelit teknik të zyrës, bënë shikimin në vend të objektit, me qëllim të kontrollit të kualitetit të punëve të kryera, veçanërisht në aspektin e plotësimit të kërkesave themelore për, **Ndërtimin e Fabrikës së ujit të pijshëm në Klinë**, dhe me këtë rast konstatoi:

- **Ndërtimin e Fabrikës për sigurimin e ujit të pijshëm në Klinë, është i ndërtuar sipas kontratës dhe parakushteve të ofruara nga projekti dhe paramasa, lidhur me ndërtimin e Fabrikës së ujit të pijshëm të lartcekur në K. Klinë.**
- **Punët e pakryera në objekt, por të parapara me Kontratë (e që duhen të kryhen në një afat të cekur në Deklaratën e kompanisë së lartcekur, datë 03.06.2013.), janë:**
  1. Blerja dhe vendosja e gjeneratorit përkatës tek Objekti i fabrikës,
  2. Shtruarja e kupëzave (kockave),
  3. Rregullimi, riparimi i rrugës në drejtim të Tikveshit.

**Kryerja e këtyre punëve është obligim i kompanisë së lartcekur dhe për moskryerja të tyre nga ana e Kompanisë, OE, do vendos sipas ligjit të Prokurimit Publik.**

Andaj, pas shqyrtimit të tërë dokumentacionit tekniko-inventiv që pati në dispozicion komisioni për punët ndërtimore, **Ndërtimin e Fabrikës së ujit të pijshëm në Klinë**, të cekur më lart dhe pas shikimit të punimeve në vend, Komisioni për pranim teknik jep këtë:

## M E N D I M

Punët e kryera me kontratë për, **Ndërtimin e Fabrikës së ujit të pijshëm në Klinë**, janë kualitative, ndërsa mungesat e cekura (punët e pakryera), duhet të kryhen në afatin e përcaktuar mes menaxherit të Projektit dhe Kompanisë së lartcekur për përfundimin në tërësi të Projektit. Lëshimi i objektit në përdorim mund të bëhet pas hulumtimit dhe analizave për ujë.

## PËRFUNDIM

Ndërtimi i Fabrikës për sigurimin e ujit të pijshëm ne Klinë, është i ndërtuar në pajtim me rregullat e ndërtimit dhe dokumentacionit teknik si dhe Kontratës ne mes te palëve.

Fabrika mund te lëshohet ne përdorim.

Vërejtjet e evidentuara për punët e pa realizuara duhet te përfundohen brenda afateve te përcaktuara me marrëveshje.

Operatori ekonomik obligohet qe punët e pa përfunduar si dhe demet e mundshme (nga mos përfundimi i këtyre punimeve) ti eliminoi me kohe.

Gjatë ndërtimit janë aplikuar normativat dhe standardet e kërkuara për këto lloje të objektit, andaj, bëhet pranim teknik I PËRKOHSHËM, deri në kalimin e afatit garantues, ku dhe bëhet pranimi teknik përfundimtar.

### Organi Mbikëqyrës:

1. Besart Gashi, Kryetar.....
2. Rasim Millaku, anëtar.....
3. Ndue Sherri, anëtar.....

### Komisionit për pranim teknik:

1. Shkëlzen Qorraj. Kryetar i Komisionit.....
2. Bekim Lushaku, anëtar.....
3. Halil Berisha, anëtar.....
4. Esat Raci anëtar.....
5. Ali Gashi, anëtar.....

Menaxheri i projektit:

Zeqir Morina

Klinë, më 03.06.2013



Ky procesverbal është hartuar ne 5 kopje.